

## **Akt Themelimi**

### **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “ COMAIN – KOSTIKA MALKALKA INVESTMENT GROUP ” Sh.p.k.**

#### **Neni 1**

##### **Themelimi**

- 1.1 Emri i shoqërise është “ **COMAIN – KOSTIKA MALKALKA INVESTMENT GROUP** ” Sh.p.k.”, (këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”). Shoqëria është themeluar në formën e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

#### **Neni 2**

##### **Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Lagjia 17, Rruga “Viktimat e 7 Shkurtit”, Nr. 4, Korçë Shqipëri**
- 2.2 Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

#### **Neni 3**

##### **Objekti**

- 3.1 Objekti i Shoqërise është si më poshtë vijon:
  - a) Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregëtare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.



- b) Në mënyrë më specifike, aktiviteti bazë i kësaj Shoqërie do të jetë:
- Import,eksport, shitje me shumicë dhe pakicë e produkteve industriale,pastrimi,elektronike,produkte ndërtimi, makineri etj.
  - Ofrimi i shërbimeve të konsulencës për shoqëritë tregëtare,individë brënda dhe jashtë Shqipërisë (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softwaresh etj.)
  - Investimi në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme).
  - Ndërmjetesim për blerje ,shitje dhe dhënie me qira të pasurive të paluajtshme.
  - Shitja,blerja,dhënia me qira e pasurive te paluajtshme.
- c) Gjithashtu, Shoqëria mund të kryej cdo veprim, operacion apo transaksion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të shoqërisë.

3.2 Objekti i Shoqërise do të jetë i kufizuar vetëm për sa më sipër parashikohen dhe nuk do të përfshijë ushtrimin e asnjë aktiviteti tjetër përveç se sa më sipër u përmendën.

#### **Neni 4** **Kohëzgjatja**

4.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

#### **Neni 5** **Kapitali Themeltar dhe Ortaket**

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lekë (njëqindmijë) i ndarë në 1 (një) kuote të zotëruar në masën 100% nga Ortaku i Vetëm.



5.2 Kapitali është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht si më poshtë vijon:

- Z. Kostika Malka, i datëlindjes 22/05/1998, lindur në Korce, mbajtës i kartës së identitetit nr 033013201, dhe nr personal J80522083P

5.3 Në bazë të kontributit të sipërcaktuar:

Z. Kostika Malka i përket 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë (“Ortaku i Vetëm”)

## **Neni 6**

### **Transferimi i Pjeseve**

6.1 Ortakët nuk kanë të drejtë të shesin, transferojë, kalojnë apo disponojnë pjesët e kapitalit në favor të ndonjë pale të tretë, pa miratimin paraprak me shkrim të Asamblesë së Ortakëve.

## **Neni 7**

### **Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve**

7.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve është organi më i lartë vendimarrës i Shoqërisë, vendimet e së cilës merren në perputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e Statutit.

## **Neni 8**

### **Administratori(et)**

8.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator i emëruar nga Asambleja e Pergjithshme Ortakëve

8.2 Administratorët e parë të shoqërise do të jenë:

- Z. Kostika Malka, i datëlindjes 22/05/1998, lindur në Korçë, mbajtës i kartës së identitetit nr 033013201, dhe nr personal J80522083P

8.3 Administratori do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 5 (pesë) vjecare, me të drejtë riemërimi.

8.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve me nënshkrimin e Administratorëve .

#### **Neni 9**

#### **Viti Financiar**

9.1 Viti financiar fillon në 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratorët hartojnë pasqyrat financiare të Shoqërisë në perputhje me ligjet në fuqi.

9.2 Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon me 31 Dhjetor të 2024.

#### **Neni 10**

#### **Te ndryshme**

10.1 Ky Akt Themelimi është nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe secila më të njëjten vlerë.

ORTAKU I VETEM

Kostika Malka

  


Datë 01/08/2024